

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

# SPACI HISTORIA E MUJË REVOLTE

Botim për sistemin  
shkollor parauniversitar

Punoi tekstin: Rovena Rrozhani  
Koordinatorë e publikimeve: Dr. Ornela Arapi  
Përgatiti për botim: Dr. Brunilda Çërraga  
Foto: Dorian Zanaliu

**Redaktore shkencore:** Prof. as. dr. Sonila Boçi

**Përpunimi grafik&kopertina:**

LH Branding

**Falënderime:**

Agron Hoxha  
Marçel Hila  
Bukuri Sokoli  
Luan Ismaili

Shtypur në shtypshkronjën "Inpress sh.p.k."

Copyright: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

AIDSSH

Spaç, historia e një revolte : botim për sistemin shkollor parauniversitar / Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit. - Tiranë : Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit - AIDSSH, 2023. 26 f. : me foto ; 20.5x28 cm

ISBN 9789928480088

1.Persekutimi politik 2.Kampe të përqëndrimit 3.Lëvizje antikomuniste 4.Historia 5.Spaç (Mirditë) 6.Shqipëri


323.282(496.524-22) "1973"

Tiranë, 2023

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

# SPAÇ, HISTORIA E NJË REVOLTE

Botim për sistemin shkollor parauniversitar



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

# Hyrje

Pas Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri, si në vendet e Europës Qendrore e Lindore, u vendos regjimi komunist, por ndryshe nga shtetet e tjera, vendi ynë iu nënshtrua modelit më të ashpër, atij stalinist. Nën udhëheqjen e diktatorit Enver Hoxha, u vendos një sistem brutal dhe ndëshkues ndaj të gjithë atyre që konsideroheshin si “armiqtë e popullit”, u krijua një atmosferë frike, shtypjeje dhe shkelje e lirive më themelore të njeriut.

Vendi u izolua nga bota e jashtme ndërsa ndërsa kundërshtarët e regjimit u izoluan nëpër burgje, kampe pune të detyruar dhe zona internimi. Të dënuarit politikë të cilët padrejtësisht akuzoheshin për “krime politike kundër shtetit, agjitacion dhe propagandë” trajtoheshin si skllëvër pune.

Mungesa e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe, veçanërisht kushtet në të cilën vuanin dënimin të burgosurit politikë ishin edhe në vëmendjen e opinionit publik botëror. Në raportin e botuar në dhjetor 1984, organizata “Amnesty International” shprehej e shqetësuar për mohimin e të drejtave të njeriut dhe kufizimin e lirive politike.

Ndërsa vinte në dukje mungesën e lirive themelore, sociale dhe politike për të gjithë shqiptarët, “Amnesty International” raportoi mungesën e garancive ligjore për të burgosurit politikë gjatë hetimeve dhe procedurave gjyqësore. Të burgosurit politikë gjatë hetimit u mbajtën në qeli të errëta, flinin ose në çimento, ose në dërrasa me batanije, por pa dyshek. Atyre u jepej shumë pak për të ngrënë. Merreshin në pyetje çdo ditë për një kohë të gjatë, por edhe natën, u nënshtrroheshin torturave, liheshin pa gjumë dhe nuk u lejohej avokati mbrojtës.

“Kushtet në kampin e Spaçit e të Ballshit, si dhe në burgun e Burrelit, ishin të rënda. Mungonte ushqimi, higjiena dhe kujdesi mjekësor, ndërsa kushtet në të cilat nxirrej bakri dhe piriti nga miniera në kampin e Spaçit ishin të rrezikshme”, thekson “Amnesty International” në raportin e vitit 1984.

## HISTORIA E REPARTIT TË RIEDUKIMIT 303

Kampi burg famëkeq i Spaçit u hap në vitin 1968, megjithatë historia e tij daton më herët, më 25 maj 1951, kur u krijua Kampi Nr. 2, i cili më pas do të quhej Reparti i Riedukimit 303. Ai shërbeu si një repart pune « lëvizës » gjatë viteve 1951-1968.

Ata që punonin aty ishin të gjithë të dënuar politikë, të cilët do të mbanin peshën e frontit më të vështirë të ndërtimit të vendit, duke u trajtuar si skllëvër pune. Ata hapën kanalet vaditës Peqin-Kavajë, Devoll-Thanë, Vjosë-Levan-Fier dhe punuan në Rrogozhinë, Harizaj, Lekaj, Gosë, Kavajë.

Nga qershori 1955, Reparti 303 punoi për 4 vite në ndërtimin e aeroportit të Rinasit. Të burgosurit politikë ndërtuan edhe Sanatoriumin, Kombinatin e Mishit, disa ndërtesa në fermën “Gjergj Dimitrov” dhe kryen një pjesë të punimeve në Uzinën e Traktorëve, në Tiranë. Në vitin 1963 reparti u transferua në Vlorë, ku punoi për ndërtimin e Uzinës së Sodës Kaustike. Dy vjet më vonë të burgosurit u dërguan në Elbasan, për të ndërtuar Fabrikën e Çimentos.

Në vitin 1968 reparti u dërgua pranë minierës së piritit në Spaç. Në janar 1969, për Repartin 303 të Riedukimit Spaç-Mirditë u hap dosja e « objektit të rëndësishëm të veçantë », i cili nënkuptonte se kontrolli ndaj të dënuarve politikë ishte më i rreptë se sa në burgje apo vende të tjera dënimi.

Në fillim Reparti 303 në Spaç kishte vetëm të dënuar politikë, por prej 1983-it, u sollën edhe të burgosur ordinerë, të cilët punonin vetëm për mirëmbajtjen e kampit dhe jo në minierë.

Për shkak të funksionit të dyfishtë si kamp pune të detyruar dhe si burg, emërtimi i plotë do të ishte burgu-kamp i Spaçit, por më tej në këtë botim, për lehtësi do t'i referohemi me termat « burg » dhe « kamp » në varësi të kontekstit.

Burgu i Spaçit, Mirditë.

# Drejt Spaçit



NURI STEPA

“Në Spaç, jemi transferuar në prill të ’68-ës. Na ngarkuan në makina me plaçka dhe me çfarë kishim me vete. **Ishim të lidhur me tela me njëri-tjetrin dhe na nxorrën nga Rrogozhina, Durrësi pastaj na kanë nisur për në Spaç të Mirditës.** Shkuam atje mbasdite në darkë.”




NEVRUZ GOLKA

“Që nga Laçi vajtëm në Elbasan. Një vit ndërtuam fabrikën e çimentos dhe në datë 7 Maj 1968, hipëm në makina bashkë me dyshekët dhe plaçkat që kishim dhe u nisëm drejt Spaçit. Udhëtuam 12 orë, nga mëngjesi deri në darkë.”

*Pjesë e shkëputur Dosja e Ish- Sigurimit të Shtetit për Objektivin e Rëndësishëm të Veçantë të Repartit 303. Spaç.*

“Gjatë kohës së punimeve për ndërtimin e fushës së aviacionit në Rinas, ka patur një rast arratisjeje nga fronti i punës nga dy të dënuar, por në sajë të veprimeve të shpejta të forcave tona dhe nga ndihma e disa fshatarëve të katundit Rinas, të arratisurit u kapën brenda ditës.”



# Ferri i diktaturës mbi tokë ose Spaç

Edhe burg edhe kamp, në kushte ekstreme të motit, nën dhunën e vazhdueshme fizike dhe psikologjike, të burgosurit politikë ishin shndërruar në skllëvër të regjimit.

Në prill 1968, në kampin e Spaçit mbërritën të dënuarit e parë politikë. Në parim ai duhet të ishte vetëm një burg, por në fakt Reparti i Riedukimit 303 u vendos pranë minierës qëllimisht, për të shfrytëzuar, me detyrim, të burgosurit politikë si forcë pune. Kapaciteti i tij fillestar ishte 504 vetë, por aty u vendosën mbi 1000 të dënuar politikë. Ata duhet t'i nënshtroheshin punës së rëndë dhe të detyruar për të nxjerrë bakër dhe pirit.

## NORMA NË MINIERË

Plani për nxjerrjen e bakrit dhe piritit përcaktohej nga komanda. Norma ditore njoftohej çdo ditë gjatë apelit. Plotësimi i normës dhe realizimi i planit ishte një kusht i padiskutueshëm për drejtuesit e kampit. Norma ditore për një vagonist ishte 4 vagona. Një vagon pirit ishte 2 tonë dhe një vagon bakër ishte 1.5 tonë. Në rast të mosrealizimit të normës, të dënuarit ndëshkoheshin dhe mbylleshin në birucat e izolimit.

## PAGESA E NJË DITE PUNE

Çdo i dënuar që realizonte normën paguhej me 10% të pagës së një minatori në liri. Në vitin 1953, kur realizonte normën 100%, i burgosuri kishte të drejtën e uljes së dënimit me 0.02 ditë në muaj dhe një pagesë që nuk kalonte 35% të vlerës së kryer. Në rast të mosrealizimit të normës, i zbritet pagesa në proporcion të kundërt. Në Korrik 1968 u hoq shpërblimi me pagesë dhe zbritje të ditëve në burg, për ata të dënuar politikë që kalonin planin me 25%, duke argumentuar se puna e detyruar nuk po shërbente për riedukim, por për përfitime personale.

**Kandil me karbit që përdorej nga të dënuarit në minierë.** Objekt nga arkivi personal i ish-të dënuarit politik, Fatos Lubonja



FATOS LUBONJA

“Nuk pranova të punoj më dhe bëra katër muaj birucë. Bëra 1 ditë grevë urie. Më sollën prokurorin, të cilit i thashë: **“Këta thonë je i dënuar me vdekje, por unë nuk jam i dënuar me vdekje. Pse më thonë po nuk dole në punë do të vdesësh?”** Unë isha në rregull, se nuk ishte punë e detyruar me vendim gjykate.”

(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç, për AIDSSH)

## FITIMET NGA PUNA E DETYRUAR

Nga viti 1968 deri në vitin 1990, rreth 2000 të dënuar dhe të ridënuar punuan në kampin e Spaçit. Nga shfrytëzimi i punës së tyre, gjatë këtyre viteve, janë prodhuar 2.82 milionë tonë bakër dhe 1.3 milionë tonë pirit. Në vitin 1981, edhe falë punës së të burgosurve politikë, prodhimi i bakrit u rrit me 4 herë, rreth 200 mijë tonë në vit.

## NJË DITË PUNE PËR TURNIN E PARË





ILIR MALINDI

**“Policët kishin një shprehje, “Onormën, oshpirtin!”.** Mosrealizimi i normës nënkuptonte birucë. Ajo ishte një lemeri më vete krahasuar me lemerinë e kampit, sepse ti ishte vetëm me një këmishë në kulmin e dimrit. Të jepnin një batanije në orën 9 të darkës dhe ta merrnin në orën 5 të mëngjesit. Gjithë ditën do të rrimin duke u hedhur përpjetë se ishte shumë ftohtë dhe po të mos lëvizje do të merrje plevitin.”

*Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH*



MUSA HOXHA

“Gjatë kohës që punova në zonën e dytë, na dhanë nga një vagon dhe një kandil me karbit. **Punonim në një temperaturë 45-50 gradë, ndërsa kur dilje jashtë mund të ishte -10 gradë.** Vagonët ishin në një gjendje shumë të keqe. Kur binin, e kishim shumë të vështirë që t’i ngrinin përsëri mbi shina dhe kjo ndodhte shpesh.”

*Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH*

# Krafftë Shqipëria

Vagon miniere në Spaç

Disa nga parullat që kanë përdorur të dënuarit gjatë revoltës dhe që janë regjistruar në raportimet zyrtare të kampit (në faqet në vijim me ngjyrë vjollcë)

# e Lirë



Trupat e betonit që përforconin galeritë e minierës në Spaç. Pjesë e Memorialit “Postblokk” në Tiranë.

**USHQIMI DHE HIGJIENA**

Menjëherë pas mbërritjes në kamp, të dënuarit i jepnin enët e ushqimit, një tas dhe një lugë. Enët e tjera silleshin nga familjarë.. Higjiena në mensë mungonte plotësisht. Shpesh vaktet ishin të pagatuara mirë dhe me papastërti. Uji i pijshëm ishte i ndotur nga mineralet e nëntokës.



FATOS LUBONJA

“Kur them 2 pjata gjellë, ishte një supë në drekë dhe një supë në darkë. Ajo supë bëhej një ditë me një grusht oriz, një ditë me një grusht makarona, një ditë me një grusht groshë dhe me 3.5 gram vaj. Po kaq vaj ishte në mbrëmje me bishta qepe, spinaq, lakër.

**Racioni i papunësisë kishte gjithsej 7 gram vaj në ditë, këto dy supat, tasin e çajit dhe 650 gram bukë.”**

*(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç, për AIDSSH)*



**Pjata dhe luga e një të burgosuri në Spaç.** Objekt nga arkivi personal i ish-të dënuarit politik, Fatos Lubonja.



HYSEN HAXHIAJ

“Për ata që ishin në punë në darkë, marmalatë me një çaj, ndërsa ata që s’punonin, vetëm një çaj”.

*(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç, për AIDSSH)*



**Gota me të cilën ka pirë çaj para pushkatimit Pal Zefi.** Objekt nga Muzeu Historik Kombëtar.



ILIAZ KAJA

“Ngrihesha në mëngjes në orën 5, laja sytë, merrja tasin e lugën dhe shkoja në mensë. Haja bukë dhe çoja tasat në vend. Ushqimi ishte ky: fillonte domatja, mbaronte domatja, fillonte speci mbaronte speci, fillonte preshi i njomë, mbaronte preshi i njomë, preshi i thatë ishte tërë krimba, por **do ta haje nga e keqja.”**

*(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç, për AIDSSH)*



**Tenxhere me të cilën kanë gatuar ish- të dënuarit politikë Ylber Merdani dhe Ali Fazolli, në Spaç.** Objekt nga Muzeu Historik Kombëtar.



GËZIM ÇELA

**“Shpesh hanim barishte... Kur kishte fasule ishte festë e madhe.”**

*(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH)*



## TË GJITHË NË UNIFORMË

Bashkë me enët, jepeshin edhe rrobat e burgut. Uniformat ngjyrë kafe dhe një tjetër uniformë blu me vija kafe dhe të bardhë, të cilat ishin për stinën e verës. Jepeshin gjithashtu 2 këmisha, 2 palë benevrekë të gjatë, pece për këmbët dhe 1 peshqir. Për dimrin ishin kapotat ushtarake të lye-ra me bojë të zezë, 4 batanije, dyshek kashte, 2 çarçafë, 2 këllëfë dhe jastëku prej kashte.



AGRON HOXHA

“Kur mbërrije në kamp, të çonin te magazina për të marrë teshat e burgut që ishin ngjyrë kafe, **merrije dyshekun prej kashte.** Në një dhomë ishim 50 vetë.”

*(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç, për AIDSSH)*

Gjatë stinës së dimrit, të izoluarve në biruca, u lejonin vetëm veshjet verore, pavarësisht temperaturave nën zero. Për të siguruar veshje të tjera, kishte të dënuar të cilët bënë triko, kapele dhe çorape leshi me shtiza. Familjarët e të dënuarve mund të sillnin vetëm ndërresa dhe sende që ishin jetike si syzet me numër, por jo syze dielli.



Shakë  
ushtare  
dësëron  
armët.

Disa nga parullat që kanë përdorur të dënuarit gjatë revoltës dhe që janë regjistruar në raportimet zyrtare të kampit

*(në faqet në vijim me ngjyrë vjollcë)*



FATOS LUBONJA

“Kur të fusnin në birucë të zhvishnin. Kishe të drejtë një palë pantallona të komandës, një kanotjere edhe një xhaketë doku të holla. Por aty ishte ftohtë. Unë e dija edhe veshja një kanotjere, një kanotjere tjetër me mëngë, këmishën edhe triko. Pra, një kanotjere dhe një triko i kisha futur tepër. Më thonë që të zhvishem. “Jo jo i thashë rregullorja nuk thotë kështu” kundërshtova unë.”

*(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH)*



HYZEN HAXHIAJ

**“Një dhomë 4 me 5 metër, 54 të burgosur brenda, me tre kate.** Unë isha në katin e tretë. Hapja kapakun e dritares aty dhe merrja ajër natën. Dyshekë kashte për secilin, por rrinin ngjitur - ngjitur dyshekët.”

*(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç, për AIDSSH)*

Veshje verore e një të burgosuri në Spaç.  
Objekt nga Muzeu Historik Kombëtar.

Syzet që mbajti në Spaç ish - i dënuari politik, Xhelal Koprencka. Objekt nga Muzeu Historik Kombëtar.



MUSA HOXHA

“Ruajta për shumë vite veshjen time të burgut... Motrave të mia ai kostum gjithmonë u ndillte njëfarë keqardhjeje dhe bezdie, ndaj e hodhën vitet e fundit.”

*(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH)*




### DHUNA FIZIKE

Kur një i dënuar nuk realizonte planin ose thyente rregulloren, për shembull: kur largohej nga fronti i punës, apo mbante sende të ndaluara, ai prangosej dhe i nënshtrohej dhunës fizike. Mjetet e tjera si, shkopi i gomës, zinxhiri, etj., përdoreshin gjithashtu për të torturuar të dënuarit.

### Pranga që janë përdorur në Spaç.


Objekt nga arkivi personal i ish - të dënuarit politik, Fatos Lubonja.



*Gu jeni katërt  
dhe kemi lëyer duart  
me gjakun tonë!*

### Mjete të tjera dhune.

Objekt nga Muzeu Historik Kombëtar.



Për t'i shpëtuar shtrëngimit të duarve, shumë të burgosur hapnin parakrahët fort, në mënyrë që polici të mos kishte mundësi të çonte hekurat deri në fund, duke krijuar një hapësirë të kyçet. Kështu shmangej dhimbja nga shtrëngimi i prangave. Sipas dëshmitarëve, këto lloj prangash quheshin pranga gjermane dhe shtrëngoheshin aq fort, sa shkaktonin gjendje të fikëti tek të dënuarit.

Disa nga parullat që kanë përdorur të dënuarit gjatë revoltës dhe që janë regjistruar në raportimet zyrtare të kampit (në faqet në vijim me ngjyrë vjollcë)

**MBIJETESA DHE ARTI**

Për t'i shpëtuar presionit të fortë fizik dhe psikologjik, lodhjes, keqtrajtimit, mallit dhe vuajtjes shpirtërore, të dënuarit gjenin të gjitha format e mundshme të ushtrimit të profesionit që kishin para se të dënoheshin. Ata bënin edhe punime artistike. Publicisti Fatos Lubonja, gjatë qëndrimit të tij në Spaç, gdhendi disa objekte artistike me bërthama pjeshke, apo kuti të veshura me farat e frutave.

Gjuha e huaj ishte e ndaluar, por mësohej në fshehtësi. Nëse gjatë kontrolleve gjendeshin libra, të dënuarit ndëshkoheshin me izolim në birucë. Krijimtaria letrare, e shkruar edhe në letra cigaresh, si në rastin e publicistit Lubonja, fshihej ose në brendësi të dyshekut të kashtës, ose në galeri. Sipas dëshmisë së ish-të dënuarit politik Agron Hoxha, shkrimtari Zyhdi Morava i fshihte krijimet e tij në një tub që gjente në galeri. Ai e shtypte në një anë tubin dhe nga ana tjetër e taposte me leckë. Këtë tub, të shndërruar në një shishe, e fuste në hapësirat e trupave të galerisë. Të dënuarit kishin një orar të shkurtër, të konsideruar si kohë të lirë, që shërbente për të luajtur shah ose domino, por pas revoltës, kjo gjë u ndalua.



*Ja vdekje*

Libër i shkruar në fletë cigareje, në kohën e burgut, nga ish - i dënuari politik, Fatos Lubonja.



MUSA HOXHA

**“Kam ndenjur në birucë një muaj, vetëm sepse kisha lexuar librin me fabulat e Ezopit.** Unë po mundohesha të mësoja disa fjalë në frëngjisht nga “Gjinkalla dhe miligona”, kur ma gjeti polici. Ishte një libër shumë i vjetër që kishte kaluar dorë më dorë.”

*(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç, për AIDSSH)*

“Një miku im takon këngëtarin Vaçe Zelën dhe e pyet për mua sepse ishim shokë fëmijërie. Ai i tregoi që Gëzimi kishte kërkuar një kitarë, dhe ajo i tha: “Çoji kitarën time!” Kështu erdhi kitara në kampin e Tiranës, pastaj e mora me vete edhe në Spaç...”

*(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH)*



GËZIM ÇELA



Punim me bërthamë pjeshke, realizuar në burg nga ish - i dënuari politik, Fatos Lubonja.

*ja libri!*

Kitara e Vaçe Zelës në Spaç. Objekt nga arkivi i ish - të dënuarit politik, Gëzim Çela.



### FLAMURI PA YLLIN KOMUNIST

Një nga çastet më kulmore të Revoltës së Spaçit ishte ngritja e flamurit pa yllin komunist. Kjo ndodhte për herë të parë pas gati 30 vitesh të regjimit diktatorial. Sipas dëshmitarëve, flamuri u ngrit gjatë mesnatës, duke gdhirë 22 maji i vitit 1973.

Për përgatitjen e tij, të dënuarit politikë morën një beze të kuqe dhe më pas njëri prej tyre, Mersin Vlashi, pikturoi shqiponjën sipas modelit në një kuti duhani. Flamuri u bë qendra e fjalimeve dhe qëndresës antikomuniste së rreth 600 të dënuarve që u përfshinë në revoltë.



NEIM PASHA

Unë thashë: “Që t’i japim një kuptim të plotë politik kësaj që po ndodh, të ngremë një flamur në cep të tarracës. Kur e vumë atje, njerëzit thanë: “Çfarë bëni? Bezja e kuqe tregon luftë, duhet shqiponja!” Piktur ishte një shoku ynë, Mersin Vlashi dhe ai bëri shqiponjën... Pasi ngritëm flamurin, erdhi Bedri Çoku dhe tha: **“Vëllezër, ky është flamuri i vërtetë i shqiptarëve, ky është flamuri i Skënderbeut, ky është flamuri i larë me gjakun e shqiptarëve në shekuj, ky është flamuri ynë!”**

(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik, Neim Pasha, dhënë për projektin “Edhe muret kanë veshë”, bashkëpunim i AIDSSH-së me Kristale Ivezaj Rama dhe Alketa Xhafa.)

“Mersin Vlashi nuk ishte piktor, por amator. Kishte bërë 7-8 vjet burg dhe ishte dënuar për së dyti. Ai në bazë të një kutie duhani që e kishte një shok, mori model shqiponjën dhe e pikturoi me bojë në bezen e kuqe.”

(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH)



SHKËLQIM ABAZI



Kutia e duhanit që shërbeu si model për shqiponjën që u vizatua në flamurin e Revoltës së Spaçit. Objekt nga Muzeu Historik Kombëtar.

### SIGURIA DHE RRETHIMI I BURGUT

Ndonëse pozita gjeografike ishte e tillë, që nuk favorizonte arratisjen e të dënuarve politikë, burgu i Spaçit, si një objekt i rëndësishëm së veçantë dhe sigurisë së lartë, kishte një rrethim të dyfishtë me tela me gjemba. Në shtylla ishin vendosur prozhektorë, me qëllim ndriçimin e zonës gjatë natës. Rrethimi i madh përfshinte: burgun, galeritë e minierës dhe malin. Ai ndërprej nga rreth 30 kulla vendroje që qubeshin karakollë. Rrethimi më i vogël ndante zonën e të burgosurve me administratën e burgut. Pikërisht jashtë këtij rrethimi, qëndronin birucati, për të shkëputur kontaktin e të izoluarve me pjesën tjetër të të burgosurve. Kampi ruhej nga ushtarë të përzgjedhur që kryenin shërbimin ushtarak. Në kuadër të sigurisë, ishin menduar edhe plane të tjera mbrojtjeje në zonat pranë kampit, në rast arratisjeje të të burgosurve.

### EKZEKUTIMET DHE TERRORI

Të burgosurit e përfshirë në Revoltën e Spaçit, Pal Zefi, Skënder Daja, Hajri Pashaj dhe Dervish Bejko u dënuan me vdekje, me akuzën për terrorizëm.

Vendi i ekzekutimit nuk dihet dhe trupat e tyre nuk janë gjetur deri më sot. Dëshmitarët rrëfejnë se fotot e viktimave iu treguan një ditë më pas të burgosurve më Spaç, për të ushtruar presion dhe për të treguar se kushdo që do të ngrinte krye, do të ndëshkohej.




GËZIM ÇELA

“Më kujtohet Skënder Daja kishte hipur në tarracë, kishte marrë kitarën që ma kishte sjellë Vaçe Zela **dhe më thoshte që të mos dorëzoheshim, se do të na pushkatonin të gjithëve.”**


(Pjesë nga dëshmia e ish-të dënuarit politik në Spaç për AIDSSH)



Faksimile e vendimit të gjyqit për dënimin me pushkatim të 4 protagonistëve të Revoltës së Spaçit. Dokument nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, dosja nr. 2364 e fondit nr. 1 Hetimor-Gjyqësor.



Faksimile e Drejtorisë së Burgjeve për pagesën e të dënuarve politikë.



# Përshkrimi kronologjik

## Origjina e REVOLTËS

Prej vitit 1968, të dënuarit politikë të kampit të Spaçit kryenin punë të detyruar në minierë. Nga shfrytëzimi i tyre çnjerëzor shteti siguronte shumë të ardhura, pasi mineralet e nxjerra në Spaç furnizonin uzina dhe fabrika në vend. Sa herë që plani nuk realizohej, të dënuarit politikë detyroheshin të punonin edhe në ditë pushimi. Pakënaqësia ishte shtuar mes të dënuarve tashmë të sflitur nga puna e rëndë dhe e papaguar, nga kushtet e

këqia të jetesës dhe nga shkelja e të drejtave njerëzore. Të dielën e 20 majit, drejtuesit e kampit të Spaçit vendosën që të mos bëhej pushim. Të dënuarit kundërshtuan, por disa prej tyre u detyruan të shkojnë në minierë me dhunë. Në çdo rast kundërshtimi, ose thyerjeje të rregullores, të dënuarit ndëshkoheshin me izolim në birucë. Ndërsa kur shkelnin ligjet që ishin në fuqi, ata arrestoheshin dhe merrnin një dënim të ri përveç dënimit që vuanin.

20 maj 1973



21 maj 1973



Ora 05.00

I dënuari Pal Gjergj Zefi, pas një muaji izolim, priste të dilte nga biruca, por në kundërshtim me rregulloren, nënoficeri i komunikoi se dënimi nuk kishte përfunduar. Ai u largua duke harruar që të mbyllte derën. Pal Zefi doli dhe shkoi drejt zonës ku qëndronin të burgosurit e tjerë. Pasi konstatoi se biruca ishte bosh, nënoficeri e kërkoi dhe gjeti të dënuarin. Ai i kërkoi atij që të kthehej në birucë, por Pali kundërshtoi përsëri.

Rreth orës 06.00

Rojet e burgut u përpoqën të prangosnin Pal Zefin. Në shenjë solidariteti, të burgosurit e tjerë reagojnë duke i dalë në mbrojtje shokut të tyre. Ata ishin të lodhur me dhunën fizike, punën e rrezikshme, kushtet mjerane të jetesës dhe padrejtësitë e vazhdueshme. Duke parë situatën e tensionuar, rojet u tërhoqën pa e kryer urdhërin për arrestimin e të dënuarit që u rebelua.

Rreth orës 16.00

U arrestua i dënuari Pal Zefi, i cili u dërgua në Degën e Punëve të Brendshme të Rrëshenit. Të burgosurit filluan të protestonin duke thirrur: “Mos e arrestoni more të poshtër!” Drejtuesit e kampit nisën të arrestonin edhe 5 të dënuar të tjerë, por hasën në qëndresën e shokëve të tyre të cilët goditën nënoficerët e rojes. Duke parë se gjendja ishte acaruar, komanda e kampit urdhëroi tërheqjen e rojeve në zonën e ndaluar. Të dënuarit hodhën parullat “Ne nuk punojmë!”, “Ju jeni katilë!”, “Ja vdekje, ja liri!”

Rreth orës 21.00

Të burgosurit thyen dhomat e izolimit dhe nxorrën të dënuarit që mbaheshin aty. Rojet hapën zjarr. Turma e të dënuarve u acarua edhe më shumë dhe u vuri flakën stendave të emulacionit socialist. U mbajtën fjalime dhe u hodhën parulla si: “Lërnini armët, bashkohuni me ne”, “Ne nuk luftojmë për vete, por edhe për ju”.

**Rreth orës 24.00**

Të dënuarit zhvilluan një mbledhje me përfaqësi nga krahina të ndryshme dhe hartuan kërkesat e tyre. U ngrit flamuri shqiptar pa yllin komunist. Një grup të burgosurish gjetën një beze të kuqe, në të cilën i dënuari Mersin Vlasi pikturoi një shqiponjë. Rreth 300 të dënuar politikë nderuan flamurin. U recituan himni dhe vjersha nga Gjergj Fishta, Fan Noli dhe Asdreni. Disa prej të burgosurve më aktivë si: Skënder Daja, Dervish Bejko dhe Hajri Pashaj mbajtën fjalime dhe hodhën parulla kundër regjimit komunist si: "Rroftë Shqipëria e lirë!", "Populli është me ne!". Rebelimi mori karakter politik dhe u shndërrua në të parën revoltë komuniste në burgjet shqiptare. Komanda e kampit lajmëroi me telegram Ministrinë e Brendshme për ngjarjen e jashtëzakonshme. Trupa të shumta policore, forcat speciale dhe ushtarake u nisën me urgjencë në drejtim të Spaçit.

**Rreth orës 03.00**

I gjithë kampi ishte në duart e të dënuarve. Brenda territorit me gjemba nuk kishte asnjë polic. Përtej tij, forcat e shumta kishin kryer rrethimin dhe po përgatiteshin për të shtypur revoltën. Në agim, në Spaç erdhi zëvendësministri i Brendshëm, Feçor Shehu, i cili bëri thirrje për t'u dorëzuar. Rreth 500-600 të burgosur, që ishin përfshirë në revoltë, nuk pranuan të dorëzoheshin.

22 maj 1973

**Rreth orës 17.00**

Autoritetet e kampit kishin ndërprerë ujin dhe ushqimin. Më të moshuarit dhe të burgosurit që ishin të sëmurë nuk po i bënin dot ballë motit të nxehtë dhe mungesës së ujit e ushqimeve. Në shenjë solidariteti, të dënuarit filluan të shpërndanin ujin dhe ushqimin që kishin rezervë me ata që ishin më të moshuar dhe më të dobët fizikisht.

**Rreth orës 09.00**

Një përfaqësi e të dënuarve politikë paraqiti kërkesat ndër të cilat : të mos punonin më në minierë, të mos dënohej asnjë pjesëmarrës në revoltë, si dhe të bëhej amnisti që prej shumë vitesh nuk ishte bërë. Pa dhënë përgjigje për kërkesat, iu kërkua të dënuarve që deri në orën 5 të pasdites të ishin dorëzuar, në të kundërt policia dhe ushtria do të ndërhynte me dhunë. Sipas disa dëshmitarëve, përveç shumë makinave me policë, ishte edhe një makinë me lëndë kimike helmuese.

23 maj 1973

Post  
**REVOLTË**



Kampi i Spaçit u bë edhe më i egër pas revoltës. Ai u shndërrua në një nga vendet më të tmerrshme të vuajtjes fizike dhe psikologjike. I tillë mbeti deri në vitin 1990, kur më 19 qershor ata pak të dënuar politikë që kishin mbetur, u zhvendosën në burgje të tjera. Me largimin e të burgosurve politikë puna në minierë kishte rënë. Kampi tashmë ishte vetëm një burg që po shkonte drejt mbylljes përfundimtare.

Më 30 shtator të vitit 1991, Parlamenti Shqiptar shpalli pafajësinë për ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë nëpërmjet ligjit nr. 7514. Në këtë ligj u vendos rehabilitimi i tyre duke u njohur të drejtën e punësimit, pensionit,

dëmshpërblimit, strehimit, shkollimit dhe kthimit të pasurisë. Shumë prej intelektualëve të njohur në fusha të ndryshme, iu rikthyen karrierës që kishin para se të burgoseshin, duke u bërë pjesë e rëndësishme e shoqërisë shqiptare pas viteve '90. Disa prej këtyre personaliteteve të njohura nuk jetojnë më si: klerikët imzot Zef Simoni, At Zef Pllumi dhe Hafiz Sabri Koçi, apo arkitekti dhe piktori Maks Velo, këngëtari Sherif Merdani, shkrimtari Zyhdi Morava, poeti Jamarbër Marko etj. Të tjerë vazhdojnë të punojnë dhe të jenë pjesë e nderuar e shoqërisë shqiptare si: Kardinali Ernest Simoni, shkrimtari dhe diplomati Visar Zhiti, publicisti Fatos Lubonja, shkrimtari dhe publicisti Daut Gumeni, juristi dhe shkrimtari Bedri Çoku etj.

Në mëngjes, pas 52 orësh përplasjeje, forcat policore dhe ushtarake hynë në rrethimin e brendshëm të burgut duke shtypur revoltën me dhunë. Një pjesë u dorëzua ndërsa një grup i vogël të dënuarish u ngjit në tarracë dhe vendosi të rezistonte deri në fund. Dhuna ndaj tyre ishte e pamëshirshme. Pasi arritën të vinin në kontroll të gjithë kampin, forcat speciale rreshtuan të dënuarit, të cilët i lidhën njëri me tjetrin. U arrestuan organizatorët e revoltës.

Mbrëmjen e 23 majit u bë gjyqi për 12 të arrestuar. Shumë prej të dënuarve nuk ishin në gjendje që të reagonin, si pasojë e dhunës së egër që ishte ushtruar ndaj tyre. Pal Zefi, Skënder Daja, Hajri Pashaj dhe Dervish Bejko u ekzekutuan me pushkatim. Të arrestuarit e tjerë u dënuan me 25 vite burg secili, përveç dënimit të mëparshëm që kishin. Dënime të reja pasuan edhe për rreth 70 të burgosur, të cilët u dërguan në hetuesinë e Tiranës menjëherë pas shtypjes me forcë të revoltës.

**TARTI**

Tarti ishte qeni i të dënuarve. Ata e kishin gjetur të vogël dhe e kishin rritur vetë. Kur polici po dhunonte të dënuarin Pal Zefi, qeni iu sul policit duke e kapur nga këmbët. Edhe gjatë shtypjes së revoltës, Tarti iu vërsul forcave speciale, që po dhunonin të burgosurit. Për pasojë policët e qëlluan sikur të ishte një i burgosur në revoltë.

**SURVEJIMI ME BASHKËPUNËTORË**

Informacionet e para për ngjarjen e Spaçit, oficeri operativ i burgut i mori nga 16 të burgosur, të cilët shërbenin si

bashkëpunëtorë me Sigurimin e Shtetit dhe ishin infiltruar prej kohësh mes të dënuarve. Organet e Sigurimit morën në pyetje të gjithë të dënuarit, për të mësuar qëndrimin që kishin mbajtur gjatë revoltës. Nga të dhënat e mbledhura dhe nga denoncimet e bëra nga 63 të dënuar, 135 persona u implikuan si pjesëmarrës në revoltë.

**PARULLAT**

Disa nga parullat që kanë përdorur të dënuarit gjatë revoltës dhe që janë regjistruar në raportimet zyrtare të kampit janë këto:

**Rroftë Shqipëria e Lirë!**  
**Ja vdekje ja liri!**

**Ne nuk punojmë as sot as mot!**

**Ju jeni katila dhe keni lyer**

**duart me gjakun tonë! Ushtria**

**është me ne! Populli është**

**me ne dhe kundër jush!**

**Shokë ushtarë dorëzoni armët! Ju**

**do të vini këtu se ju**  
**është ngushtuar rrethi!**

**Do t'ju djegin si Stalinin! Mos u**

**gënjeni se kurrë në botë nuk do të**

**fitojë komunizmi! Poshtë komunistë!**

**Rroftë Europa e lirë!**

**Arsyet e Revoltës**

*Ish- i dënuari politik Shkëlqim Abazi rendit disa arsye të cilat nxitën Revoltën e Spaçit:*

- Terrori psikologjik i ushtruar nga komanda rast pas rasti;
- Ndëshkimet mizore deri në humbje jete;
- Mungesat e gjata në furnizimet me ushqime dhe veshmbathje;
- Ndërprerjet e qëllimshme të takimeve me familjarët;
- Kontrollat e njëpasnjëshme dhe sekuestrimet e librave;
- Aksidentet me pasojë humbjen e jetës në galeritë e pasigurta;
- Mosrespektimi i pushimit javor;
- Higjiena mjerane në kuzhinë, mensë dhe banja;
- Hapësira e kufizuar në fjetore;
- Presionet politike të komandës.

*(Marrë nga libri "Spaçi, varri i të gjallëve")*

**Përse e përkujtojmë Revoltën e Spaçit?**

*Përkujtimi i kësaj revolte ka rëndësi për disa arsye:*

- Të nderojmë dhe të kujtojmë ata që i rezistuan dhunës dhe represionit të një regjimi që mohoi disa prej të drejtave më themelore të njeriut.
- Të mësojnë mbi dhunën dhe shkeljen e të drejtave të njeriut nga regjimi totalitar në Shqipëri, veçanërisht në burgjet dhe kampet e punës.
- Të njohim burimet parësore historike, ta kuptojmë historinë dhe ndikimin e saj në ditët e sotme.
- Të mësojmë nga gabimet e të shkuarës për të mos i përsëritur ato.
- Të kujtojmë që duhet të ketë liri dhe drejtësi për të gjithë.
- Të frymëzohemi për të vepruar për kauza që mbrojnë të drejtat e njeriut.



## Fjalorth

**AGJITACION DHE PROPAGANDË** është një nga nenet më famëkeqe, sipas të të cilit çdo njeri që shprehte me gojë apo me shkrim një mendim që nuk ishte në linjë me politikën e partisë në fuqi, akuzohej se bënte agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit, se e minonte dhe dobësonte atë me qëllimin rrëzimin e tij. (Për më shumë lexo nenin 73 të ligjit 1470/1952)

**BASHKËPUNËTOR I ISH-SIGURIMIT TË SHETITIT** është çdo person që ka bashkëpunuar me Ish-Sigurimin e Shtetit për të gurmuar, përgjuar dhe mbledhur informacion për individë të cilët dyshohej se kishin një qëndrim të kundërt politik me partinë në pushtet. (Për më shumë lexo nenin 3, pika 4 e Ligjit 45/2015 i ndryshuar “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”)

**DOKUMENTE TË ISH-SIGURIMIT TË SHETITIT** janë të gjitha burimet e shkruara, vizive e materiale si: dokumente, harta, filma, regjistrime audiovizuale etj., të krijuara nga struktura e Ish-Sigurimit të Shtetit, si edhe nga institucione që bashkëpunonin me të si: gjykatat, prokurori, komitetet e partisë në pushtet etj. (Për më shumë lexo nenin 3, pika 5 e Ligjit 45/2015 i ndryshuar)

**ISH-SIGURIMI I SHETITIT** ishte shërbimi i sigurimit kombëtar, inteligjencës dhe i policisë sekrete në Shqipërinë komuniste. Detyra e tij ishte që të mbronte Shqipërinë nga rreziqet e jashtme dhe të brendshme. Në të vërtetë Ish-Sigurimi i Shtetit u kthye në “armën e Partisë” kundër kundërshtarëve politikë, qofshin këta të vërtetë apo imagjinarë. (Për më shumë lexo në faqen zyrtare të Shërbimit Informativ të Shtetit)

**KAMPI I PUNËS SË DETYRUAR** është ai vend ku njerëzit mbahen si të burgosur dhe detyrohen që të bëjnë punë të rëndë fizike. Territori ku vendosen të burgosurit është i rrethuar me tela, brenda të cilit janë ndërtuar fillimisht baraka me materiale të lëvizshme si: dërrasa, llamarina, katrama për të mbuluar çatitë etj. (Për më shumë lexo në botimin “Historik i shkurtër i Repartit të Riedukimit 303 në Spaç-Mirditë)

**PUNË E DETYRUAR** quhet çdo punë ose shërbim që i kërkohet një individ kundër vullnetit të tij, duke e kërcënuar me një dënim të çfarëdoshëm. (Për më shumë lexo Udhëzuesin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut)

**PUNËTORI OPERATIV** është punonjësi që ka qenë në marrëdhënie pune, i cili ka patur funksione zyrtare në strukturën e Ish-Sigurimit të Shtetit. (Për më shumë lexo nenin 3, pika 4.1 e Ligjit 45/2015 i ndryshuar)

